



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 2648/4 Prot.

Durrës, më 18.12.2024

V E N D I M

Nr. 67, Datë 18.12.2024

P Ë R

**"MIRATIMIN E KAPACITETEVE PRITËSE NË PROGRAMIN E STUDIMIT TË
CIKLIT TË TRETË "DOKTORATË" NË "SHKENCA EDUKIMI" PËR VITIN
AKADEMIK 2024-2025, PRANË FAKULTETIT TË EDUKIMIT, UNIVERSITETI
"ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar, kreu 4/F; të Udhëzimit Nr. 25, datë 28.12.2021 "Për disa ndryshime në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020"; në përcaktimet e VKM-së Nr.112, datë 23.2.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor"; në Urdhrin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me Nr. 602, datë 19.10.2023, si dhe në shkresën Nr. 2626 prot., datë 18.12.2024 të Drejtorisë së Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave, në mbledhjen e datës 18.12.2024, Senati Akademik i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës,

V E N D O S I :

1. Miratimin e kapaciteteve pritëse në programin e studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" në "Shkenca Edukimi" për vitin akademik 2024-2025, pranë Fakultetit të Edukimit, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Zv.Rektorët
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore
 - Drejtoria e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R
Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

